

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

Konfidencialiteti financiar dhe e drejta
për mbrojtjen e të dhënave financiare
në kontekstin e Bashkimit Evropian

Ana DURAKU



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTORË

Ana Duraku

VITI I PUBLIKIMIT

gusht 2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave financiare në aktet e Këshillit të Europës	05
Standardet e Bashkimit European për mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave financiare	06
Përfundime	09
REFERENCA	10

Konfidencialiteti i të dhënave financiare është bërë një nga çështjet më të ndjeshme në epokën dixhitale, ku informacioni ekonomik i individëve dhe bizneseve qarkullon përmes sistemeve gjithnjë e më të automatizuara. Rritja e përdorimit të teknologjive të avancuara në sektorin financiar, si dhe përhapja e shërbimeve online të pagesave, ka zgjeruar ndjeshëm volumin dhe natyrën e të dhënave që mblidhen, përpunohen dhe ruhen nga institucionet publike dhe private.

Të dhënat financiare luajnë një rol kyç në një sërë procesesh që lidhen me zbatimin e ligjit, si hetimet penale, lufta kundër pastrimit të parave, ndjekja e politikave fiskale nga shtetet, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve financiare etj. Edhe pse nuk ekziston një përkufizim i unifikuar i “të dhënave financiare” në legjislacionin e Bashkimit Europian, nëse këto të dhëna lidhen me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm, ato trajtohen si të dhëna personale në kuptimin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR). Krahas kësaj rregulloreje, ekzistojnë edhe direktiva sektoriale që vendosin detyrime specifike për përpunuesit e të dhënave në sektorë të caktuar. Një prej tyre është Direktiva për Shërbimet e Pagesave (PSD2), e cila detyron institucionet financiare të lejojnë qasjen e palëve të treta të autorizuara në të dhënat e klientëve, me qëllim lehtësimin e konkurrencës dhe funksionimin e tregut të përbashkët dixhital të shërbimeve financiare në Bashkimin Europian.

Të dhënat që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me veprimet monetare ndërmjet palëve njihen si “të dhëna transaksionesh”, pasi ato pasqyrojnë

transferimin e shumave nga një subjekt tek tjetri. Në kuadër të kuadrit rregullator të BE-së, veçanërisht në PSD2, përdoret koncepti i “të dhënave të ndjeshme të pagesave”, që përfshin informacione të tilla si kredencialet personale të sigurisë, numrat e kartave bankare dhe kodet mbrojtëse të cilat, nëse bien në duar të gabuara, mund të përdoren për mashtrime[1].

Në linjë me këto qasje dhe bazuar në avancimet teknologjike dhe shkencore, GDPR zbatohet sa herë që të dhënat personale përpunohen nga subjekte tregtare të vendosura brenda territorit të Bashkimit Europian, ose kur përpunimi lidhet me individë që ndodhen brenda BE-së me synim mbrojtjen e individëve nga përdorimi i padrejtë i të dhënave të tyre personale, duke vendosur parime dhe rregulla të qarta për përpunuesit e të dhënave. Ajo përcakton detyrime specifike për të ashtuquajturit “kontrollues të të dhënave” dhe “përpunues të të dhënave”, përfshirë përgjegjësinë për të garantuar respektimin e të drejtave të individëve në lidhje me të dhënat e tyre personale, siç janë e drejta për informim, qasje, korigjim, fshirje dhe portueshmëri të të dhënave. Në këtë mënyrë, GDPR vendos një ekuilibër të domosdoshëm midis nevojave të tregut financiar për të përdorur të dhëna në mënyrë efikase dhe të drejtave të qytetarëve për mbrojtje të jetës private dhe kontroll mbi informacionin personal[2].

Në dekadat e fundit, janë vërejtur dy zhvillime të rëndësishme që kanë sjellë në vëmendje çështjen e privatësisë në fushën financiare. Tendenca e parë lidhet me dixhitalizimin e parasë dhe të tregtisë, e cila ka sjellë një rritje të ndjeshme të vëllimit dhe qarkullimit të të dhënave financiare. Shtete si

Suedia[3] dhe Holanda[4] kanë raportuar një përdorim më të madh të transaksioneve dixhitale në krahasim me pagesat në para të gatshme, madje edhe për shuma të vogla, duke sinjalizuar një largim të qëndrueshëm nga përdorimi fizik i parasë[5].

Tendenca e dytë, e cila buron nga ky transformim teknologjik, është rikonfigurimi i modelit ekonomik që mbështet ofrimin e shërbimeve financiare[6]. Këto shërbime po strukturohen gjithnjë e më shumë rreth vlerës së gjeneruar nga mbledhja dhe analizimi i të dhënave. Teknologjitë e reja që mundësojnë mbledhjen, ndërlidhjen dhe përpunimin masiv të informacionit duke përfshirë të dhënat financiare dhe sjelljet online të përdoruesve kanë integruar sistemet financiare në logjikën e ekonomisë së informacionit.

Në këtë kontekst, teknologjia nuk ka ndikuar vetëm mënyrën se si qarkullojnë paratë, por edhe ka transformuar thelbësisht kuptimin dhe pritshmëritë që kemi mbi administrimin e informacionit personal. Aktorë të rinj si ofruesit e pagesave elektronike (p.sh. PayPal, AliPay) apo korporatat ndërkombëtare të kartave të pagesave (si MasterCard dhe Visa) kanë fituar pozita dominuese globale, kryesisht falë kapaciteteve të tyre për të mbledhur, analizuar dhe përdorur të dhëna në mënyrë që të optimizojnë shërbimet e tyre dhe të krijojnë avantazhe konkurruese në treg[7].

Me këto zhvillime të shpejta teknologjike dhe transformime të tregjeve financiare, mbrojtja e të dhënave financiare nuk mund të shihet më si një çështje e izoluar teknike, por si një dimension thelbësor i të drejtave themelore dhe i integritetit institucional në një shtet të së

drejtës. Për vendet në proces integrimi në Bashkimin Europian, si Shqipëria, harmonizimi me standardet europiane për privatësinë dhe sigurinë e të dhënave nuk përbën vetëm një kërkesë formale, por një sfidë reale që prek funksionimin e administratës shtetërore, besimin e qytetarëve dhe vetë strukturën dixhitale mbi të cilën ndërtohen funksionet publike të shtetit. Ky studim synon të trajtojë pikërisht këtë ndërthurje mes zhvillimeve teknologjike, interesave tregtare dhe detyrimeve për të garantuar mbrojtjen efektive të të dhënave financiare në përputhje me parimet themelore të acquis së BE dhe të drejtës europiane.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave financiare në aktet e Këshillit të Europës

Më 28 janar 1981, Këshilli i Europës miratoi Konventën për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale, e njohur gjerësisht si Konventa 108[8]. Shqipëria e ka ratifikuar këtë instrument ndërkombëtar përmes ligjit nr. 9288, datë 7.9.2004[9], duke e integruar atë në sistemin juridik kombëtar. Në maj të vitit 2018, Konventa iu nënshtrua një procesi modernizimi, përmes miratimit të Protokollit të ri (CETS nr. 223), i cili përfaqëson versionin e përditësuar të saj, Konventa 108+[10]. Shqipëria e nënshkroi këtë protokoll më 28 janar 2022 dhe e përfshiu në legjislacionin e saj me ligjin nr. 49/2022, duke përafuar më tej kuadrin kombëtar me standardet bashkëkohore europiane për mbrojtjen e të dhënave personale[11].

Edhe pse në kuptimin teknik të Konventës 108+ të dhënat financiare nuk klasifikohen si “të dhëna sensitive”, natyra e tyre delikate dhe ndikimi që ato kanë në jetën personale dhe ekonomike të individëve i jep atyre një rëndësi të veçantë praktike dhe juridike. Informacioni mbi transaksionet, llogaritë bankare apo modelet e shpenzimeve mund të mos zbulojë drejtpërdrejt bindje politike, fetare apo shëndetësore[12], por përmes analizës së tyre mund të nxirren përfundime të detajuara për mënyrën e jetesës, sjelljen konsumatore dhe madje edhe zgjedhjet personale të një individ. Në këtë kuptim, qasja bashkëkohore ndaj të dhënave financiare kërkon që mbrojtja e tyre të

mos kufizohet në ndarjen formale sipas kategorive ligjore, por të mbështetet në një analizë gjithëpërfshirëse të rreziqeve që përpunimi i këtyre të dhënave mund të sjellë për të drejtat dhe liritë e individit. Kjo përfshin jo vetëm masa të zakonshme sigurie, por gjithashtu nxit nevojën për zhvillimin e mekanizmave më proaktivë të transparencës, mbikëqyrjes dhe kontrollit individual mbi të dhënat duke hapur kështu rrugën për një debat më të gjerë mbi balancimin ndërmjet inovacionit financiar dhe mbrojtjes së privatësisë.

Ky kuadër fillestar rregullator u pasurua më tej me miratimin e Rekomandimit Rec(90)19 në vitin 1990[13], i cili, megjithëse me natyrë jo detyruese, u shndërrua në një pikë referimi të rëndësishme për zhvillimin e politikave europiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave financiare. Ky rekomandim erdhi si përgjigje ndaj rritjes së përdorimit të mjeteve elektronike të pagesës dhe tendencës në rritje drejt dixhitalizimit të operacioneve financiare, duke theksuar nevojën për standarde të përbashkëta që garantonin siguri, privatësi dhe transparencë në përpunimin e informacionit financiar personal.

Rekomandimi nisët nga ideja se informacioni financiar, si për shembull të dhënat që lidhen me llogaritë bankare, historikun e transaksioneve ose autorizimet e pagesave, përbën të dhëna personale nëse lidhet me një individ të identifikueshëm. Në këtë kuadër, dokumenti thekson nevojën për kufizim të mbledhjes së të dhënave financiare vetëm në ato që janë të domosdoshme për qëllime të përcaktuara dhe legjitime, si përpunimi i

pagesave, mbajtja e shënimeve kontabël apo mbrojtja nga abuzimet. Ai kërkon që çdo mbledhje, ruajtje dhe përdorim i të dhënave financiare të jetë proporcionale dhe e lidhur me një funksion të ligjshëm të sistemit të pagesave. Në mënyrë të veçantë, ndalon përpunimin e mëtejshëm të të dhënave për qëllime të tjera, si marketingu apo ndarja me palë të treta, pa pëlqimin e shprehur të subjektit të të dhënave. Kjo është e rëndësishme pasi përpunimi i të dhënave financiare mund të zbulojë sjellje të ndjeshme, modele konsumi apo informacione për jetën personale të individëve[14].

Përveç këtyre instrumenteve themelore, Këshilli i Europës ka zhvilluar gjithashtu udhëzime specifike për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT).[15] Këto udhëzime i përgjigjen sfidave që paraqet përpunimi i të dhënave financiare në një kontekst ku autoritetet shtetërore kërkojnë të parandalojnë dhe zbulojnë modele të krimeve financiare, por njëkohësisht kanë detyrimin të ruajnë nivelin e duhur të mbrojtjes të së drejtës së individit për privatësi.

Këshilli thekson rëndësinë e ruajtjes së një ekuilibri të drejtë ndërmjet nevojës për siguri financiare dhe detyrimit për mbrojtjen e privatësisë së individëve. Udhëzimet nënvizojnë rëndësinë e transparencës në mënyrën e përpunimit të të dhënave, zbatimin e parimeve të proporcionalitetit dhe nevojës, si dhe sigurimin e masave efektive mbrojtëse që kufizojnë aksesin dhe ruajnë integritetin e informacionit. Në këtë mënyrë, përpunimi i të dhënave financiare për qëllime të sigurisë socio-ekonomike nuk duhet të kryhet në dëm të standardeve të mbrojtjes dhe të drejtave themelore të individëve[16].

Standardet e Bashkimit European për mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave financiare

Industria financiare po kalon një periudhë ndryshimesh të thella si rezultat i zhvillimeve të vazhdueshme teknologjike dhe përdorimit në rritje të analizës së të dhënave. Kjo ka sjellë një orientim të qartë drejt datalizimit të proceseve financiare, ku institucionet përpunojnë të përmirësojnë vendimmarrjen, menaxhimin e rrezikut dhe ofrimin e shërbimeve të personalizuar për klientët përmes analizës së të dhënave masive. Përballë këtij realiteti të ri, ka qenë e nevojshme ndërtimi i një kornize ligjore që siguron akses të sigurt dhe etik ndaj të dhënave financiare, si dhe ruan privatësinë dhe integritetin e tyre. Në këtë drejtim, Bashkimi European ka paraqitur iniciativën për Rregulloren mbi Qasjen në të Dhënat Financiare (FIDA), me synimin për të rritur transparencën dhe bashkëpunimin midis aktorëve të sektorit financiar[17].

FIDA ndërtohet mbi përvojën e mëparshme me sistemin e Open Banking, të zhvilluar në kuadër të Direktivës për Shërbimet e Pagesave (PSD2) [18] dhe synon të krijojë një treg të vetëm të të dhënave financiare, ku përdoruesit kanë kontroll më të madh mbi informacionin e tyre dhe ku institucionet financiare dhe ofruesit e palës së tretë mund të ndajnë të dhëna në mënyrë të standardizuar, të sigurt dhe të drejtë duke shtrirë kështu konceptin në të ashtuquajturën “Financa të hapura”. Kjo qasje e re përfshin edhe rregullore të tjera që synojnë rritjen e qëndrueshmërisë

teknologjike dhe përbalueshmërisë ndaj rreziqeve dixhitale, si Rregullorja për Qëndrueshmëri Operacionale Dixhitale (DORA)[19].

FIDA prek në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat themelore të konsumatorëve, në veçanti të drejtën për respektimin e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të garantuara nga nenet 7 dhe 8 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European. Përmes këtij kuadri të ri ligjor, parashikohet vendosja e të drejtave të qasjes në të dhënat financiare, me qëllim të rritjes së mundësive për ndarje të të dhënave përfshirë edhe ato personale vetëm kur kërkohet shprehimisht nga vetë klienti. Për të ruajtur balancën midis qasjes dhe mbrojtjes së të drejtave, kjo rregullore synon të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, siç kërkohet nga neni 38 i Kartës së BE-së. Ndarja e të dhënave do të jetë e kushtëzuar rreptësisht me pëlqimin dhe kërkesën aktive të individit. Më tej, masat si krijimi i një paneli kontrolli (dashboard) për autorizimet e qasjes dhe udhëzimet e synuara për fushat me rrezik të lartë përjashtimi do të kontribuojnë në rritjen e besimit të përdoruesve dhe do t'u japin atyre më shumë kontroll mbi ndarjen e të dhënave të tyre personale.

Përdorimi i këtyre të dhënave do të jetë i kufizuar vetëm për shërbimin e kërkuar, duke ndaluar rishfrytëzimin e tyre për qëllime të tjera. Një element i ri është edhe krijimi i një kategorie specifike për ofruesit e shërbimeve të informacionit financiar të autorizuar, të cilët do të mund të përpunojnë të dhëna vetëm nëse përmbushin kriteret e sigurisë dhe besueshmërisë. Për më tepër, si mbajtësit ashtu

edhe përdoruesit e të dhënave do të jenë të detyruar të respektojnë rregullat e vendosura nga Rregullorja për Qëndrueshmërinë Operacionale Dixhitale (DORA), e cila ofron masa të forta për mbrojtjen nga keqpërdorimi i të dhënave dhe shkeljet e mundshme të sigurisë[20]. Në thelb, kjo iniciativë përfaqëson një hap drejt modernizimit të tregut financiar european, duke siguruar që zhvillimet teknologjike të shoqërohen me mbikëqyrje të përshtatshme dhe mbrojtje të të dhënave të qytetarëve.

Një nga prioritetet kryesore të politikës financiare të Bashkimit European ka qenë dhe forcimi i integritetit të tregjeve financiare, duke parandaluar keqpërdorimin e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e çmimeve në treg. Për të adresuar këto problematika, Komisioni European propozoi në vitin 2011 dy nisma legjislative me rëndësi të veçantë.

E para është një rregullore e re që synon të vendosë rregulla të përbashkëta për parandalimin dhe luftimin e praktikave të padrejta tregtare, me qëllim mbrojtjen e funksionimit të drejtë të tregjeve dhe forcimin e besimit të investitorëve në të gjithë Bashkimin European[21]. Kjo rregullore synon të harmonizojë kuadrin ekzistues ligjor ndërmjet shteteve anëtare dhe të garantojë qasje më koherente ndaj abuzimeve të tregut.

Propozimi i dytë përfshin një direktivë që trajton aspektin penal të këtyre veprave, duke parashikuar sanksione penale për ata që përfshihen në përdorimin e paligjshëm të informacionit të

brendshëm apo në manipulime të tregut.[22] Ky akt synon të forcojë ndëshkueshmërinë dhe të rrisë rolin parandalues të sistemit ligjor në këtë fushë.

Së bashku, këto dy nisma synojnë jo vetëm përputhjen ligjore në nivel të BE-së, por edhe ngritjen e një sistemi më efikas për identifikimin, hetimin dhe ndëshkimin e sjelljeve që dëmtojnë besueshmërinë dhe funksionimin korrekt të tregjeve financiare në Europë.

Qëllimi kryesor i ndalimit të përfitimit nga informacioni i brendshëm në tregjet financiare është të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në treg, duke parandaluar që individët me qasje në informacion të fshehtë të përfitojnë në mënyrë të padrejtë, në dëm të investitorëve të tjerë që nuk e zotërojnë këtë informacion. Kjo barazi është një nga parimet themelore të mbrojtjes së integritetit të tregjeve të BE-së.

Rregullorja për Abuzimin me Tregun e njeh rëndësinë e të dhënave të trafikut të komunikimeve elektronike si mjet për të zbuluar dhe provuar veprime si manipulimi i tregut apo tregtia me informacion të brendshëm. Megjithatë, ajo nuk i jep shteteve anëtare të drejtën të kërkojnë ruajtje të përgjithshme dhe të pakufizuar të këtyre të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik. Përkundrazi, Rregullorja i referohet vetëm të dhënave që tashmë ekzistojnë dhe që mund të kërkojnë nga autoritetet financiare në përputhje me rregullat përkatëse.

Gjykata e Drejtësisë së BE-së ka sqaruar se Direktiva 2002/58/EC, e cila rregullon

privatësinë në fushën e komunikimeve elektronike, përbën bazën ligjore për trajtimin e të dhënave personale në këtë kontekst. Si rrjedhojë, çdo kërkesë për akses apo ruajtje të të dhënave nga autoritetet shtetërore, përfshirë edhe ato financiare, duhet të respektojë këtë direktivë dhe interpretimet e dhëna nga Gjykata në vendimet e saj. Në përputhje me këtë kuadër ligjor, Gjykata ka theksuar se nuk lejohet një regjim i përgjithshëm dhe i parapranuar i ruajtjes së të dhënave me qëllim parandalimin e abuzimeve në treg. Masa të tilla të gjera dhe të paindividualizuara bien ndesh me të drejtat themelore për mbrojtjen e jetës private dhe të dhënave personale, siç janë garantuar nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian[23].

Në Shqipëri, kuadri ligjor ekzistues ofron një bazë, por ende nuk është i plotë për të mbështetur një model të tillë. Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë”, i cili përpiqet të përputhet me standardet europiane, përmban parime të rëndësishme si pëlqimi, proporcionaliteti, ligjshmëria, transparenca, etj., por zbatimi i tyre në praktikë është i fragmentuar, veçanërisht në fushën financiare[24].

Ligji nr. 9662/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” përcakton detyrime për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të klientëve, megjithatë, ky ligj është më shumë i orientuar drejt mbrojtjes institucionale sesa drejt fuqizimit të individit si zotërues i të dhënave të veta[25].

Po ashtu, Shqipëria ka ndërmarrë hapa për të reflektuar pjesërisht direktivën PSD2 për shërbimet e pagesave[26], por nuk ka ende një akt të posaçëm që të rregullojë në mënyrë gjithëpërfshirëse ndarjen e të dhënave financiare siç bën FIDA. Kjo mungesë krijon një boshllëk ligjor, ku individit shpesh mbetet i pambrojtur, sidomos kur përdor shërbime dixhitale të palëve të treta.

Për më tepër, rreziku nuk qëndron vetëm tek ndarja e të dhënave, por edhe tek siguria e tyre. Në këtë drejtim, BE ka miratuar rregulloren DORA (Digital Operational Resilience Act), e cila nuk rregullon ndarjen e të dhënave si FIDA, por kërkon që çdo institucion financiar të garantojë qëndrueshmëri teknologjike dhe mbrojtje ndaj sulmeve apo abuzimeve dixhitale. Shqipëria aktualisht nuk ka një rregullore të ngjashme që të përforcojë sigurinë dixhitale në sektorin financiar në të njëjtin nivel.

Në këtë realitet, qytetari shqiptar që nga sipërmarrësi i vogël e deri te një përdorues i zakonshëm i shërbimeve online shpesh përballet me një sistem ku nuk është plotësisht i ndërgjegjshëm se si përdoren të dhënat e tij financiare, kush i qaset atyre, dhe për sa kohë. Kjo krijon jo vetëm pasiguri teknike, por edhe mungesë besimi në shërbimet dixhitale.

Për të avancuar drejt një dixhitalizimi të qëndrueshëm të sistemit financiar, Shqipëria duhet të ndërtojë një kuadër ligjor të përputhshëm me standardet europiane një strukturë që garanton siguri juridike, rregulla transparente dhe vendos qytetarin në qendër si zotërues i të drejtave mbi të dhënat e tij.

Vetëm kur individit ka kontroll të plotë mbi informacionin personal dhe çdo përdorim i të dhënave bëhet me miratimin e tij të informuar, mund të ndërtohet një ekonomi dixhitale që reflekton interesat e qytetarit dhe jo e kundërta.

[1] Direktiva (BE) 2015/2366 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 25 nëntor 2015. Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm, që ndryshon direktivat 2002/65/KE, 2009/110/KE dhe 2013/36/BE dhe rregulloren (BE) nr. 1093/2010 dhe shfuqizon direktivën 2007/64/KE. Neni 4(32). Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian (OJ) L 337, datë 23.12.2015.

[2] Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 27 prill 2016. Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave. Nenet 12-43. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian L 119/1, datë 4.5.2016.

[3] Bank for International Settlements. (2023). Digital payments make gains but cash remains. Klikuar në linkun https://www.bis.org/statistics/payment_stats/commentary2301.pdf

[4] Sveriges Riskbank. (2025). Payments Report. Klikuar në linkun <https://www.riksbank.se/globalassets/media/rapporter/betalningsrapport/2025/engelsk/payments-report-2025.pdf>

[5] OECD. (2020). Përdorimi i të dhënave personale në shërbimet financiare dhe roli i edukimit financiar: Një analizë me qendër konsumatorin. Klikuar në [Personal Data Use in Financial Services and the Role of Financial Education | OECD](#).

[6] Forumi Ekonomik Botëror (World Economic Forum). (2018). Përdorimi i përshtatshëm i të dhënave të klientëve në shërbimet financiare. Klikuar në linkun [WP Roadmap Appropriate Use Customer Data.pdf](#).

[7] VISA. Annual Report. (2024). Klikuar në linkun https://s29.g4cdn.com/385744025/files/doc_downloads/2024/Visa-Fiscal-2024-Annual-Report.pdf

[8] Këshilli i Europës, Konventa për Mbrojtjen e Individëve ndaj Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale, miratuar më 28 janar 1981, ETS nr. 108, Strasburg.

[9] Ligji nr. 9288, datë 7.9.2004 “Për ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79/2004.

[10] Këshilli i Europës, Protokolli i ndryshuar i Konventës për Mbrojtjen e Individëve ndaj Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale (Konventa 108+), miratuar më 18 maj 2018, CETS nr. 223, Strasburg.

[11] Ligji nr. 49, datë 12.5.2022 “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79/2022.

[12] Konventa 108+. Neni 6.

[13] Këshilli i Europës. (1990). Rekomandimi Nr. R (90) 19 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura për pagesa dhe veprime të tjera të lidhura. Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 13 shtator 1990. Klikuar në linkun <https://rm.coe.int/16804e2c0f>.

[14] Po aty.

[15] Këshilli i Europës. (2017). Udhëzime mbi mbrojtjen e të dhënave në kontekstin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT). Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave, Strasburg. Klikuar në linkun: <https://rm.coe.int/guidelines-aml-cft-and-data-protection/168076605a>

[16] Këshilli i Europës, Udhëzime mbi mbrojtjen e të dhënave për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, PREMS 109823, gusht 2024, Strasburg. Klikuar në linkun <https://rm.coe.int/prems-109823-gbr-2051-guidelines-aml-cft-a5-web/1680b156d9>

[17] Komisioni Europian. (2023). Propozim për Rregullore mbi kuadrin për Qasjen në të Dhënat Financiare (FIDA). Klikuar në linkun <https://finance.ec.europa.eu>.

[18] Autoriteti Bankar Europian (EBA). (2022). Raport mbi ndikimin dhe efektivitetin e PSD2. Klikuar në linkun https://www.eba.europa.eu/sites/default/files/document_library/Publications/Opinions/2022/Opinion%20od%20PSD2%20review%20%28EBA-Op-2022-06%29/1036016/EBA%27s%20response%20to%20the%20Call%20for%20advice%20on%20the%20review%20of%20PSD2.pdf

[19] Komisioni Europian. (2022). Rregullorja (BE) 2022/2554 Për Qëndrueshmërinë Operacionale Dixhitale për Sektorin Financiar (DORA). Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian L 333, 27.12.2022.

[20] Komisioni Europian, Propozim për Rregulloren e Parlamentit Europian dhe të Këshillit për një kuadër për Qasjen në të Dhënat Financiare dhe për ndryshimin e Rregulloreve (BE) nr. 1093/2010, (BE) nr. 1094/2010, (BE) nr. 1095/2010 dhe (BE) 2022/2554, COM(2023) 360 final, Bruksel, 28 qershor 2023.

[21] Komisioni Europian. Propozim për Rregullore të Parlamentit Europian dhe të Këshillit mbi keqpërdorimin e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut (abuzimi në treg), COM(2011) 651 final, Bruksel, 20 tetor 2011.

[22] Komisioni Europian. Propozim për Direktivë të Parlamentit Europian dhe të Këshillit mbi sanksionet penale për keqpërdorimin e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut, COM(2011) 654 final, Bruksel, 20 tetor 2011.

[23] Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian. Vendimi i 20 shtatorit 2022 (Dhoma e Madhe). VD dhe SR, çështjet e bashkuara C-339/20 dhe C-397/20, EU:C:2022:703.

[24] Ligji nr. 124, datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë”, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, datë 17.01.2025.

[25] Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.149, datë 31.12.2006.

[26] Ligji nr. 55, datë 30.04.2020 “Për shërbimet e pagesave”, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 02.07.2020; Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë. Vendimi nr. 59, datë 21.12.2022 “Për miratimin e rregullores ‘Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave’”. Klikuar në linkun https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Rregullore_Nr_59_2022_23814.pdf.